



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DHOMA E AVOKATISË
E SHQIPËRISË



ALBANIAN
CHAMBER OF ADVOCACY



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MES

DHOMËS KOMBËTARE TË AVOKATISË

DHOMËS KOMBËTARE TË NDËRMJETËSVE

DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERËVE

**DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË PRIVATË**

Në njohje të rolit thelbësor që luajnë profesionet e lira ligjore në garantimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve shqiptarë;

Duke vlerësuar sfidat e reja të vendosjes së shtetit ligjor dhe elementeve përbërës të tij;

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet noterëve, përmbaruesve gjyqësorë privatë, avokatëve dhe ndërmjetësve për përmirësimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë në Shqipëri;

Duke synuar ngritjen e standardeve profesionale, transparencës dhe efikasitetit të profesioneve tona në interes të qytetarëve;

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi:

Dhoma Kombëtare e Noterëve, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (në vijim: Dhomat),

Nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi

Neni 1 Objektivat

1. Me këtë Memorandum, Dhomat synojnë:
 - a) Promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë për të garantuar mbështetje dhe ndihmë profesionale në interes të drejtësisë dhe qytetarëve.
 - b) Ngritjen dhe harmonizimin e standardeve të etikës dhe praktikës profesionale në të gjitha profesionet e lira ligjore.
 - c) Krijimin e një platforme të përhershme të dialogut dhe shkëmbimit të informacionit për sfidat dhe zgjidhjet e mundshme në zbatimin e ligjit.
 - d) Rritjen e transparencës dhe përmirësimin e praktikave të shërbimit ndaj qytetarëve përmes seminareve, simpoziumeve dhe projekteve të përbashkëta.
 - e) Inkurajimin e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e profesioneve të lira ligjore dhe rolin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe bizneseve.

Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

1. **Shkëmbimi i informacionit dhe ekspertizës-** Dhomat angazhohen për të ndarë informacion mbi ndryshimet ligjore, praktikat më të mira dhe sfidat profesionale për të rritur efektivitetin në ushtrimin e profesioneve përkatëse.
2. **Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta-** Planifikimi dhe organizimi i seminareve, konferencave dhe grupeve të punës për çështje me interes të përbashkët që lidhen me drejtësinë dhe zbatimin e ligjit.
3. **Promovimi i profesioneve respektive** dhe nxitja e përdorimit të tyre, si mjet efikas ligjor për qytetarët shqiptarë dhe jo vetëm.
4. **Standardizimi i procedurave-** Hartimi i orientimeve të përbashkëta për të siguruar transparencë, korrektësi dhe profesionalizëm për procedurat e ndjekura nga profesionistët ligjorë në komunikimin në raport me administratën dhe qytetarët.

Neni 3 Organizimi dhe zbatimi

1. Dhomat do të krijojnë një **Komitete Koordinues** të përbërë nga një përfaqësues i secilës Dhomë. Ky komitet do të mbajë takime periodike për të monitoruar zbatimin e këtij Memorandumi.
2. Komiteti Koordinues do të mbledhet së paku dy herë në vit për të diskutuar progresin, sfidat dhe planet e ardhshme të bashkëpunimit dhe/ose në raste të veçanta kur kërkohet nga një prej Dhomave përkatëse lidhur me situata të veçanta që referon profesioni.
3. Komiteti do të përgatisë një raport vjetor për aktivitetet e kryera dhe për arritjet në kuadër të këtij Memorandumi.

**Neni 4
Kostot**

1. Shpenzimet për zbatimin e këtij Memorandumi do të ndahen në mënyrë të drejtë ndërmjet Dhomave, bazuar në angazhimet specifike për çdo aktivitet të miratuar nga Komiteti Koordinues.

**Neni 5
Kohëzgjatja**

1. Ky Memorandum ka një kohëzgjatje të pacaktuar dhe mbetet në fuqi deri në një vendim të kundërt të marrë unanimisht nga Dhomat.

**Neni 6
Ndryshimet dhe plotësimet**


1. Çdo ndryshim ose plotësim i këtij Memorandumi duhet të bëhet me miratimin unanimit të përfaqësuesve të të gjitha Dhomave.

**Neni 7
Ratifikimi**

1. Ky Memorandum hyn në fuqi pas nënshkrimit nga përfaqësuesit ligjorë të të gjitha Dhomave dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale.

Nënshkruar nga:


MAKSIM HAXHIA
Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë




MIMOZA SADUSHI
Kryetare e Dhomës Kombëtare të Noterëve



DRITA AVDYLI
Kryetare e Dhomës
Kombëtare të Ndërmjetësimit



TEDI MALAVECI
Kryetar i Dhomës
Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë



Tiranë, datë 20 dhjetor 2024